

Ceremonia e dhënies së titullit “Honoris Causa” për dy personalitete të shquara akademike të botës shqiptare, Akademikun Shaban Sinani dhe Prof.dr. Arben Malaj.

Më datë, 12.04.2019, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, organizoi ceremoninë e dhënies së titullit “Honoris Causa” për dy personalitete të shquara akademike të botës shqiptare, Akademikun Shaban Sinani dhe Prof.dr. Arben Malaj

Akademik Shaban Sinani dhe Prof.dr. Arben Malaj me angazhimet e tyre, intelektuale, akademike, dhe me një përkushtim të madh kanë promovuar, kulturën, traditat dhe çka është më e rëndësishmja kanë promovuar vlerat e vendit tonë.

Të dy këto personalitete janë shembulli më i mirë i ndërtimit të miqësive dhe urave të komunikimit që do duhej të ishte mision i akademikëve që edukojnë brezat e rinj.

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, duke e vlerësuar si të rëndësishme punën e Akademik Shaban Sinanit dhe Prof.dr. Arben Malaj si akademikë të shquar, e vlerësojmë që dhënia e titullit “Honoris Causa” i bënë nder institucionit tonë dhe njëherësh i hapë rrugën e bashkëpunimit me universitete prestigjioze ku të dy këto personalitete të shquara ushtrojnë veprimtarinë akademike dhe shkencore.





